

Engjëll I. BERISHA

POEZI ME SHPIRT DHE SA SHUMË DASHURI

Veprat e artit bëhen me figura të virtytshme për të edukuar dhe për të na mbushur shpirtin me dinjitet, sepse, ndryshe mbesim të zbrazët dhe na mund frika nga e shëmtuara që na rri tek dera, nëse ne ia japim mundësinë të na pushtojë. Për këtë, krijuesit, e më së shumti poetët, dhurojnë mendime për të na dhënë sa më të shpjegueshme misterin e dashurisë.

Në këtë rast, në veprën më të re, “Sy të pafajshëm...”, poeti, krijuesi me dimensione në rritje, Besim Xhelili, i vë përballë dy parime që i studion me të madhe estetika, botën trupore dhe shpirtërore, ku fjalën e tij, poezinë, e bën shpirt të lëvizshëm, në shumë raste shpirti i tij është shumë i ndjeshëm dhe krenar, përderisa shpesh bie në frikë nga dhembshuria, si një lloj ndrydhje me frikë të shpërfaqur. Duke e lexuar me vëmendje veprën dhe në krahasim me poezitë e tjera nga ky autor, s’ka se si të mendohet ndryshe, pos asaj se, poeti inkurajon lexuesin, ne që e lexojmë na mban të ushqyer, na kthen te realiteti ynë, me siguri shumica e kemi përjetuar, me një fjalë, na mban aktivë, akt përjetues.

Për të qenë në raport të mirë me jetën e me të tjerët, gjithnjë shërbehemi me bukurinë, me dashurinë, me drejtësinë, me të cilat parime krijohet shpirti estetik e që mundëson të ndriçohemi në mes veti. Kjo thirrje vjen edhe prej vetë Krijuesit, ku në jetën e përditshme kemi vërtetuar se mendimet e zemrës, formësojnë karakterin moral, një lloj ligji i shpirtit që na udhëheq më së miri.

Mendimtarët të bukurën e kanë quajtur koncept i mendjes, virtytet e së cilës përjetohen ndryshe nga forca e mendimit, por, siç e përshkruajnë që të gjithë, dashuria, është diçka më e thellë që pasqyron të plotë shpirtin njerëzor.

Kush është personazhi aktiv i veprave të Besim Xhelilit? Nëse themi se personazh figurativ është dashuria, pa emër, por e tëra e përshkruar në ndjenjë, ky është realiteti dhe besimi e pranimi i vetvetes, me këtë e ushtron mendjen për bindje të sigurtë, edhe pse në fakt bie një dozë lajthitjeje pasi që kësaj dashurie ia zë frymën një zemërim, ku duket edhe si mekanizëm mbrojtës për ta ruajtur nga lëndimi dhe kurrresi të ndryshojë sistemin e bindjeve që e ka ndaj kësaj ndjenje: *“Kanë mbetur fshetur çastet e lumturisë, oh vdiqa/ Ankthi më përmbys shpirtin e lodhur, sa larg që je! /Ndodh dhe qaj e qesh e tek ti më shkon mendja /Mall i madh më pushton papritmas dhe m'lëndon...”*.

Njeriu më së shumti vuan për ta bindur vetveten me atë çka dëshiron dhe sikur nuk ia lejojmë vetvetes të na plotësohen dëshirat. Kjo e humb ekuilibrin në mes mendjes e trupit, përderisa psikologjia thotë se nuk jemi vetvetja. Ndërsa te poezitë e veprës më të re të autorit Besim Xhelili, na jep një edukim për lidhjet emotive, për ndjenjën e vetëfajësimit, ku lexuesi në mes rreshtave e nxjerr porosinë e çlirimit nga e kaluara, përballë së cilës edhe mendimin “është mahnitëse, të pranosh dashurinë”. Dashuria është aristokracia e të gjitha ndjenjave, në mesin e së cilës ka një ulëse dhe vetë poeti Besim Xhelili.